



REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA

---

**K.DH.SH.II.nr.1238/22**

**GJYKATA KOMERCIALE NË PRISHTINË** - Dhoma e Shkalles se Dytë, me gjyqtarin Faton Bajrami, në çështjen përmbartimore të kreditorit R... me seli ne Prishtinë, ndaj debitorit “A...” me seli ne Prishtinë, me bazë juridike përmbartimore, duke vendosur lidhur me ankesën e palës se tretë M.G e përfaqësuar nga D.O avokat ne Prishtinë, të ushtruar kundër aktvendimit të Gjykatës Themelore në Prishtinë-Departamenti i Përgjithshëm, PPP.nr.601/19, të datës 18.01.2022, me datë 26.09.2022, mori këtë:

**A K T V E N D I M**

**REFUZOHET** e pathemeltë ankesa e palës se tretë M.G, ndërsa aktvendimi i Gjykatës Themelore në Prishtinë-Departamenti i Përgjithshëm, PPP.nr.601/19, të datës 18.01.2022, **VËRTETOHET**.

**A r s y e t i m**

Gjykata Themelore në Prishtinë-Departamenti i Përgjithshëm me aktvendimin e atakuar PPP.nr.601/19, të datës 18.01.2022, e ka refuzuar prapësimin e palës se tretë M.G nga Prishtina, e përfaqësuar nga avokat D.O, te ushtruar kundër Urdhrit për përmbartim, E.nr.372/11 te datës 20.02.2012 e lejuar nga Gjykata Komunale ne Vushtrri (e pranuar nga Përmbartuesi privat Atip Mustafa me seli ne Mitrovicë, me numër 08/17 te datës 05.01.2017), ndërsa urdhrin për lejimin e përmbartimit e ka lënë ne fuqi.

Kundër këtij aktvendimi në afatin ligjor ka ushtruar ankesë pala e tretë M.G përmes avokatit D.O, me arsyetimin se përmbartimi është caktuar ne sende te cilat janë përjashtuar nga përmbartimi dhe si rezultat i kësaj mundësit për kryerjen e përmbartimit janë te kufizuara nga neni 71 par.1 nenpar.1.5 te LPP, duke pretenduar se sendet qe janë objekt i përmbartimit cenojnë te drejtën e palës se tretë nga neni 75 par.1 te LPP, si dhe për shkak te shkeljes thelbësore të dispozitave të procedurës te LPP dhe shkeljes e dispozitave te Procedurës Kontestimore, me

propozim qe gjykata e shkalles se dytë ta aprovoj këtë ankesë si te bazuar, ta prish aktvendimin e gjykatës se shkalles se parë dhe çështjen ta kthej ne rivendosje.

Përgjigje ne ankesë ka paraqitur kreditori me arsyetimin se arsyet e dhëna nga pala e tretë janë te pabazuara sepse dispozitat e LPP dhe LPDTS parashohin mjaftë qartë se ne cilat raste është i pamundur përbarimi dhe dihet se cilat sende nuk mund te jenë objekte te lëna peng, andaj kreditori pretendon se me mjetet siguruese te kredisë se regjistruar peng dhe hipotekë, cilat ka qenë ne pronësi te kredimarrësit e realizon kredinë – kërkesën e tij, pasi qe te njëjtat ne regjistra përkatës kanë figuruar si pronësi te evidentuara ne emër te tij. Lidhur me pronësinë e përbashkët pronaret e përbashkët duhet te përgjigjen me pronën e tyre pranë kreditoreve, e ku dispozitat e nenit 274 pika 3 e LFK, ne mënyrë shprehimore parashohin mundësinë dhe rrethanat se kur anëtari i bashkësisë familjare e ne mënyrë analoge sipas nenit 175 te këtij ligji bashkëshorti mund ta kontestoj marrëveshjen mbi ngarkimin apo tjetërsimin e paluajtshmerisë dhe atë vetëm ne dy kushte, ndërsa sa i përket pretendimeve te debitorit vlerëson se gjykata e shkalles se parë ka shqyrtuar perëndimet e palës debitore ne prapësim dhe shkaqet mbi te cilat mund te parashtrohet prapësimi dhe ka vërtetuar faktin se pretendimet e palës se tretë nuk janë ne përputhje me nenin 71 te LPP.

Dhoma e Shkalles se Dytë e Gjykatës Komerciale, i shqyrtoi shkresat e lëndës, aktvendimin e atakuar dhe pretendimet ankimore, në kuptim të nenit 3, paragrafi 2, të Ligjit nr.04/L-139 për Procedurën Përbarimore si dhe në kuptim të nenit 194 dhe 208 të LPK-së, gjeti se:

Ankesa e debitorit është e pathemeltë.

Nga shkresat e lëndës rrjedh se kreditori R... nga Prishtina, me datën 18.10.2011, ka paraqitur propozim për përbarim ndaj debitorit "A..." me përfaqësues A.G, në bazë të dokumentit përbarues - kontratës për hipotekën nr. ... te muajit Tetor 2008, marrëveshjes për linjën e kredisë nr. .... dhe marrëveshjes mbi kredinë NR. .... te datës 12.09.20002.

Gjykata Komunale ne Vushtrri duke vepruar sipas propozimit për përbarim të kreditorit, me urdhrin përbarimor P.nr.372/11 te datës 18.10.2011, e ka caktuar përbarimin në bazë të dokumentit përbarimor, ndërsa pala e tretë përfaqësuar nga avokat D.O me datë 11.03.2019, ka parashtruar prapësim, duke pretenduar se ajo si palë e tretë është atakuar sepse i është cenuar e drejta, duke qene se e njëjta është bashkëshortja e debitorit te parë A.G dhe pretendon se pasuria e fituar gjate martesës është pasuri e përbashkët, e ku ne baze te nenit 75 te LPP personi i trete ne këtë rast M.G ka te drejtën qe ne lidhje me objektin qe është caktuar për realizimin e përbarimit mund te paraqes prapësim deri ne përfundimin e procedurës përbarimore. Me tej pala e trete ka pretenduar se, e ka vërtetuar drejtën e saj ne baze te provave materiale si dokument publik (aktvendimi i Gjykatës Themelore ne Mitrovicë-Dega ne Vushtrri) ne kuptim te nenit 76 par.4 e LPP , dhe neni 259 te LPP, prandaj Gjykatës Themelore ne kuptim te nenit 259 par.2 te LPP te

vendos meritorisht përkitazi prapësimit te palës se tretë e qe e drejta e palës se tretë përfshin parcelën kadastrale me shenje 277 nr.44/e zona kadastrale ne Vushtrri. Propozon qe gjykata e shkalles e dyte ta aprovoj këtë prapësim, ta shfuqizoj urdhrin për lejim te përmbarimit dhe ta ndryshoj aktvendimin për lejimin e përmbarimit.

Përgjigje në prapësimin e ushtruar nga pala e tretë M.G, ka parashtruar debitori A.G, me datë 25.03.2019, me të cilën i nuk ka kontestuar pretendimet e palës se tretë te cekura në prapësim, me arsyetimin se nuk i konteston pretendimet dhe shkaqet e paraqitura na prapësim sa i përket fakti se parcela lëndore është krijuar gjate ekzistimit te martesës, përmes kontributit te palës se trete ne rritjen e pasurisë se përbashkët, me tej ka parashtruar se nuk kontestohet fakti se këtu pala e tretë nuk ka dhënë pëlqimin për lidhjen e kontratës se hipotekës dhe nuk kontestohet fakti se aktvendimi me shenjë C.nr.518/14 i Gjykatës Themelore ne Mitrovicë Dega ne Vushtrri i datës 25.11.2014 përmes se cilit është caktuar masa e sigurisë ne parcelën lëndore, paraqet pengesë për realizimin e përmbarimit, andaj ne bazë te nenit 259 te LPP gjykata e shkalles se pare ka te drejt te vendos merita për prapësimin e palës e tretë.

Gjykata Themelore në Prishtinë - Departamenti i Përgjithshëm duke vendosur lidhur me prapësimin e palës se tretë ka nxjerrë aktvendimin PPP.nr.601/19, të datës 18.01.2022, me të cilin e ka refuzuar në tërësi si të pabazuar prapësimin e palës e tretë M.G nga Prishtina duke vendosur si në dispozitiv të të njëjtit. Në arsyetim të aktvendimit të atakuar gjykata ka theksuar pretendimet e palës se tretë sa i përket masës se vendosur ne procedurën kontestimore nuk paraqesin pengese ne procedurën përmbarimore qe te vazhdohet me tej me ekzekutimin e marrëveshjes se pengut dhe se fakti se pala e trete ka siguruar një kërkesë nuk paraqet arsye për pezullim te procedurës përmbarimore. Po ashtu gjykata e shkalles e pare thirret ne nenin 76.4 te LPP, duke sqaruar se masa e sigurisë ne procedurën përmbarimore ka për qellim sigurimin kërkesës deri ne vendosje meritore për çështjen lëndore. Vendosja për masën e sigurisë është vendim procedural, por një vendim i tille nuk paraqet themelësinë e prapësimit siç kërkohet ne nenin 76 par.4 te LPP dhe pala e trete nuk ka paraqitur si prove një aktgjykim te formës se prerë apo ndonjë vendim qe ka peshe ekuivalente qe do ti jepte te drejte meritore palës për ta pezulluar procedurë, ashtu qe nuk ka gjetur prova bindëse ne prapësimin e palës se tretë nga te cilat do te plotësohej ndonjëra nga bazat e parapara me nenin 71 te LPP.

Dhoma e Shkalles se Dytë e Gjykatës Komerciale vlerëson se gjykata e shkallës së parë, në bazë të provave të cilat gjinden në shkresat e lëndës, ka marr aktvendim të drejtë dhe të bazuar në dispozita konkrete ligjore, i njëjti është i kuptueshëm dhe i qartë, prandaj vendimin e gjykatës, lidhur me këtë çështje e pranon edhe kjo gjykatë, duke vlerësuar se aktvendimi i atakuar është i rregullt dhe i ligjshëm, për arsye se i njëjti nuk është përfshirë në shkelje thelbësore të dispozitave të procedurës kontestimore nga neni 182, paragrafi 1 dhe 2 të LPK-së, dhe se drejtë është vërtetuar

gjendja faktike, kështu që mund të hetohet dhe vlerësohet ligjshmëria e tij, shkelje të cilat gjykata e shkallës së dytë i heton sipas detyrës zyrtare në bazë të nenit 194 të LPK-së.

Nisur nga kjo gjendje e çështjes, Gjykata Komerciale – Dhoma e shkalles se dytë, vlerëson se gjykata e shkallës së parë i ka zbatuar drejtë dispozitat e Ligjit të Procedurës Përmbartimore kur ka refuzuar prapësimin e palës e tretë, të paraqitur kundër urdhrin përmbartimor, me të cilin është caktuar përmbartimi i propozuar nga kreditori, ngase edhe sipas vlerësimit të kësaj gjykate me shikimin në shkresat e lëndës qartë konstatohet se përmbartimi është lejuar në bazë të Marrëveshjes për kredinë nr. .... te datës 12.09.2008, Marrëveshjes për linjën e kredisë nr. .... te datës 15.03.2011 dhe Marrëveshjes për hipotekën nr. .... e muajit Tetor 2008, aktvendimit nr.85/08 te datës 07.10.2008 lëshuar nga Zyra Komunale e Kadastrit ne Vushtrri, mbi regjistrimin e Hipotekës, dhe te njëjtat paraqesin dokumente përmbartuese në kuptim të dispozitës së nenit 5 paragrafi 2 të Ligjit nr.05/L-118, për Ndryshimin dhe Plotësimin e LPP-së, shprehimisht përcaktohet se: *Neni 22 i ligjit bazik, paragrafi 1., pas nën-paragrafit 1.7., shtohet nën-paragrafi i ri 1.7a. me tekstin si në vijim kontrata për pengun e regjistruar në regjistrin zyrtar të pengut*”, e që në rastin konkret janë përmbushur të gjitha kushtet e parapara ligjore për lejimin e përmbartimit.

Po ashtu kolegji i shkalles se dyte, vlerëson se nuk qëndron pretendimi i palës se tretë ne ankesë se masa e përkohshme qe është nxjerr me vendimin C.nr.518/14 dt.11.03.2019 nga Gjykata e Themelore ne Mitrovicë i jep te drejte palës se tretë ne lidhje me objektin qe është caktuar për realizim te përmbartimit. Kjo nuk qëndron sepse masa nuk paraqet ndalesë ne procedurën e përmbartimit që te vazhdohet me ekzekutim te marrëveshjes mbi pengun pasi është vendim procedural. Andaj eshë kjo gjykatë vlerëson nenin 76 par.4 te LPP, e cila përcakton se *“Gjykata do te vendos për prapësimin e personit te tretë ne procedurën e përmbartimit sa herë qe një gjë te tillë do lejojnë rrethanat e rastit konkret, e sidomos kur parashtruesi i prapësimit e provon themelësinë e prapësimit te tij me anë te aktgjykimit te formës se prerë, me anë te dokumentit publik, ose me anë te dokumentit jo-publik te certifikuar sipas ligjit”*. Andaj edhe procedura kontestimore nuk e ndalon kreditorin qe te vazhdoj me procedurën e iniciuar sipas marrëveshjes mbi pengun-hipotekën, nga rezulton se aktvendimi i ankimuar i nxjerrë nga gjykata e shkallës së parë është i drejtë dhe i ligjshëm. Vlerëson se pala e tretë ne rastin konkret nuk ka ofruar prova juridikisht te vlefshme ne mbështetje te pretendimeve te paraqitura ne prapësim, konform nenit 69 par.4 te LPP, e po ashtu nuk janë plotësuar as arsyet nga neni 71 te LPP. Andaj edhe në këtë drejtim këto pretendime të palës se tretë rezultuan si të pathemelta të cilat gjykata ankimore vendosi ti refuzojë ndërsa aktvendimin e atakuar vendosi ta vërtetojë.

Kompetenca e Dhomës se Shkalles se Dytë për të vendosur nga ana e gjyqtarit individual bazohet në dispozitën e nenit 3 paragrafi 2 të LPP-së, me të cilën është paraparë se në shkallën e dytë vendimet i nxjerr gjyqtari individual.

Nga të gjitha arsyet e paraqitura e në pajtim me dispozitat e nenit 208 dhe 209 paragrafi 1 pika (b) të LPK lidhur me nenin 17 të LPP, u vendos si në dispozitiv të këtij aktvendimi.

GJYKATA KOMERCIALE NË PRISHTINË,  
DHOMA E SHKALLES SE DYTË  
K.DH.SH.II nr.1238/22, me datë 26.09.2022

Gjyqtari  
Faton Bajrami